Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/17
Datë: 28.01.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Rregulloren Nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, neni 5 paragrafi 4, 5 dhe 6, si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET aplikacioni/kërkesa e dt. 31.07.2024 e Institucionit "Oda Ekonomike e Kosovës" me adresë: Rr. Nëna Terezë, nr. 20, Prishtinë, Republika e Kosovës, për akreditim dhe validim për kualifikimet:

   1.1 Vlerësues i Biznesit, Niveli 5 i KKK, me 25 kredi të AAP

   1.2 Instruktor i shoferëve, Niveli 5 i KKK, me 7 kredi të AAP

   1.3 Vlerësues i pronave të paluajtshme, Niveli 5 i KKK, me 6 kredi të AAP (Riakreditim dhe Rivalidim)

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Oda Ekonomike e Kosovës" me adresë: Rr. Nëna Terezë, nr. 20, Prishtinë, Republika e Kosovës ka parashtruar në AKK aplikacionin/kërkesën nr. 31.07.2024 për akreditim dhe validim të kualifikimit: Vlerësues i Biznesit, Niveli 5 i KKK-se, Instruktor i shofereve, Vlerësues i pronave të paluajtshme, Niveli 5 i KKK.

Ekspertet e AKK-së brenda afatit ligjor kanë marrë në shqyrtim për vlerësim aplikacionin e dorëzuar nga ana e Institucionit "Oda Ekonomike e Kosovës".

Me datë 23.08.2024, ekspertet e AKK-së përmes emalit zyrtar bazuar në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak pas konstatimeve se aplikacioni nuk është i kompletuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë kërkuar nga institucioni që në afat prej pesë (5) dite ta përmirësojnë aplikacionin bazuar në udhëzimet e eksperteve të AKK-së dhe të njëjtin pas plotësimit të mangësive të identifikuara ta dorëzojnë në AKK për vlerësim. Institucioni "Oda Ekonomike e Kosovës" ka marrë nga AKK dosjen e aplikimi bazuar në rekomandimin e ekspertëve për përmirësim, dhe të njëjtën brenda afatit të dhënë e kanë dorëzuar në AKK.

Ekspertët e AKK- së me datë 26.09.2024 kanë hartuar raportin vlerësues për aplikacionin e Institucionit "Oda Ekonomike e Kosovës" dhe kanë konstatuar se edhe pas rishikimit të dosjes në afatin e dhënë nga AKK pala aplikuese nuk ka bërë të gjitha përmirësimet e kërkuara.

Andaj, bazuar në nenin 7 paragrafi 2 dhe 7 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak ekspertet e AKK-së i kanë rekomanduar Këshillit Drejtues që aplikacioni të refuzohet.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Oda Ekonomike e Kosovës"
2. Arkivit të AKK-së.

Valmira Sejdiu

Nënkryetare e KD